

NDREQJE GABIMI

Në vendimin e ERE-s nr. 220, datë 1.9.2022 “Për miratimin e ndryshimeve në rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 125, datë 20.9.2022, bëhet korrigjimi si më poshtë:

Në nenin 4, “Licencat”, pika 4:

Ishte: Për aq sa e lejon legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë, nuk do të kërkohet aplikimi për licencim për tregtimin e energjisë elektrike ose furnizimin me energji elektrike, në rast se një shoqëri ka një licencë të lëshuar nga një autoritet rregullator i një vendi tjetër Palë Kontraktore e Komunitetit të Energjisë/një Shteti Anëtar të Bashkimit Evropian ose një vend tjetër me të cilin është nënshkruar një marrëveshje dypalëshe, për njohjen reciproke të licencave ndërmjet ERE-s dhe autoritetit përkatës rregullator, si dhe me kusht që ato të dorëzojnë në ERE licencën e përkthyer dhe noterizuar, si dhe informacionin e përcaktuar në nenin 9(1) dhe 9(2), germa “c”, të këtyre rregullave.

Bëhet: Për aq sa e lejon legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë, nuk do të kërkohet aplikimi për licencim për tregtimin e energjisë elektrike ose furnizimin me energji elektrike, në rast se një shoqëri ka një licencë të lëshuar nga një autoritet rregullator i një vendi tjetër Palë Kontraktore e Komunitetit të Energjisë/një shteti Anëtar të Bashkimit Evropian ose një vend tjetër me të cilin është nënshkruar një marrëveshje dypalëshe, për njohjen reciproke të licencave ndërmjet ERE-s dhe autoritetit përkatës rregullator, si dhe me kusht që ato të dorëzojnë në ERE licencën e përkthyer dhe noterizuar, si dhe dokumentacionin e përcaktuar në shtojcën 1/K të këtyre rregullave.

Në nenin 8, “Paraqitja e aplikimit”, pika 3:

Ishte: Dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi duhet të jetë në gjuhën shqipe, origjinal ose fotokopje e noterizuar dhe një kopje elektronike në CD, USB ose me *e-mail* në adresën zyrtare të ERE-s, ndërsa vërtetimet dhe deklaratat nga organet e tjera duhet të jenë lëshuar jo më parë se 1 muaj nga momenti i paraqitjes së aplikimit.

Bëhet: Dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi duhet të jetë në gjuhën shqipe, origjinal ose kopje e njësuar me dokumentin origjinal ose me nënshkrim/vulë elektronike, në rastin kur këto aplikohen. Vërtetimet dhe deklaratat duhet të jenë lëshuar jo më parë se 1 (një) muaj nga momenti i paraqitjes së aplikimit.

Në shtojcën 1, “Formati i aplikimit”, germa “b”

Në pikën 6 të tabelës hiqet fjala “Funksioni”.

Në shtojcën 1/D, pika 6, “Në rastet e aplikimit për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, bashkëlidhur duhet depozituar, gjithashtu”:

Ishte: Bilanci financiar i 3 (tre) vjetëve të fundit/ose kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë e krijuara rishtazi), të audituar (kur kjo kërkohet nga ligji) dhe/ose dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe mbështetjen financiare (financim i vetë aplikuesit, kredi ose garanci bankare, donacion etj.) për ushtrimin e veprimtarisë, sipas llojit të aplikimit, bazuar në këtë dokumentacion.

Bëhet: Bilanci financiar i 3 (tre) vjetëve të fundit/ose kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë e krijuara rishtazi), të audituar (kur kjo kërkohet nga ligji) dhe/ose dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe mbështetjen financiare (financim i vetë aplikuesit, kredi ose garanci bankare, donacion etj.) për ushtrimin e veprimtarisë, sipas llojit të aplikimit, bazuar në këtë dokumentacion. (në rastin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike, mbështetja financiare duhet të garantojë të paktën 1 (një) muaj të ushtrimit të aktivitetit, referuar sasisë së parashikuar nga vetë aplikuesi).

Në shtojcën 1/E, “Në rastet e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, bashkëlidhur duhet depozituar gjithashtu”:

Numeracioni ishte: 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19.

Numeracioni bëhet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.

Pika 6, sipas numeracionit të ri, ishte: Bilanci financiar i 3 (tre) vjetëve të fundit/ose kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë e krijuara rishtazi), të audituar (kur kjo kërkohet nga ligji) dhe/ose dokumente, që vërtetojnë aftësinë dhe mbështetjen financiare (financim i vetë

aplikuesit, kredi ose garanci bankare, donacion etj.) për ushtrimin e veprimtarisë, sipas llojit të aplikimit, bazuar në këtë dokumentacion.

Bëhet: Bilanci financiar i 3 (tre) vjetëve të fundit/ose kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë e krijuara rishtazi), të audituar (kur kjo kërkohet nga ligji) dhe/ose dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe mbështetjen financiare (financim i vetë aplikuesit, kredi ose garanci bankare, donacion etj.) për ushtrimin e veprimtarisë, sipas llojit të aplikimit, bazuar në këtë dokumentacion. (në rastin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, mbështetja financiare duhet të garantojë të paktën 1 (një) muaj të ushtrimit të aktivitetit, referuar sasisë së parashikuar nga vetë aplikuesi).

*Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin Tuaj,
Me respekt,*

KRYETAR
Petrit Ahmeti